



**Hapet thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së,
për semestrin e parë të vitit akademik 2025 - 2026
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107
në Technical University of Crete (TUC), Greqi.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Technical University of Crete, publikohet thirrja për mobilitete për studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Technical University of Crete.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Fushat e studimit: Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.

Kohëzgjatja e bursës: Semestri i II i vitit akademik 2026 - 2027

Numri total i studentëve: 2 (Bachelor dhe/ose Master)

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është: English-B1.*

Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Mobility Plan’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në TUC lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘Learning Agreement’ te seksioni ‘Commitment’ firmoset nga aplikanti, nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Bashkëlidhur gjeni formatin e “Learning Agreement”.

Për t’u njohur me listën e lëndëve të ofruara nga TUC, ju lutemi klikoni te:

[International Study Programmes - Technical University of Crete](#)

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:

Deri më 28 shtator 2026, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al